



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.564/2023
Datë: 27 dhjetor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në vazhdimin e takimit 318-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. Të gjitha lëndët në Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, nga 1 janari 2024, të përfundojnë përmes Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nga Departamenti për Teknologji Informative në SKGJK është njoftuar për nivelin e vënies në zbatim deri tani të Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL) në Gjykatën Komerciale dhe aktiviteteve që duhet për të funksionalizuar në tërësi sistemin në gjykatë, duke përfshirë edhe shpërndarjen automatike të lëndëve te gjyqtarët përmes sistemit.

Këshilli, ka pranuar informacionin se në Gjykatën Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, pavarësisht se nuk është duke funksionuar sistemi i shpërndarjes automatike të lëndëve, lëndët mund të përfundohen në sistem, andaj Këshilli në funksion të rritjes së transparencës dhe për të mundësuar zbatimin e Strategjisë për Qasje në Drejtësi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Departamentit të TIK në SKGJK;
- Kryetarit të Gjykatës Komerciale
- Sekretariatit të KGJK-së dhe
- Arkivit.

